

NDERTIMI I UJESJELLESIS RAJONALE I MOKRES (FAZA I)

RAPORTI TEKNIKE

Projekti i Ujesjellesit Njesia Administrative Velçan dhe Proptisht

Qershor 2020

Tabela e Permbajtjes

3.1	Vendndodhja	2
3.2	Hyrja ne vend	3
3.3	Klima	3
3.4	Topografia	3
3.5	Kushtet Gjeoteknike dhe Hidrogjeologjike	5
	3.5.1 Burimi dhe Linja Kryesore Derguese	5
	3.5.2 Karakteristikat e Tokes ne zonen e rezervuarit .	5
	3.5.3 Fshati	6
	3.5.4 Hidrogjeologjia	6
3.6	Sizmiciteti	7
4.1	Popullsia	7
4.2	Situata Socio-Ekonomike	11
4.3	Gjendja Mjedisore	11
6.1	Gjendja Aktuale	12
	6.1.1 Skema Aktuale e Operimit	12
	6.1.2 Permbledhje e Projektimit	13
6.2	Projekti	15
	6.2.1 Nevojat per uje	18
	6.2.2 Llogaritjet e volumit te rezervareve	20
	6.2.3 Nevojate per zjarrfikesen	21
	6.2.4 Kriteret e Projektimit	21
	6.2.5 Llogaritjet hidraulike	21
	6.2.6 Llogaritja e Grushtit Hidraulik	24
6.3	Pershkrimi i Punimeve	24
	6.3.1 Materiali per Tubat dhe Rakorderite	24
	6.3.2 Linja kryesore derguese	25
	6.3.3 Kanali i tubacionit	25
	6.3.4 Ajruesit	26
	6.3.5 Shkarkuesit	26
	6.3.6 Pusetat e komandimit	26
	6.3.7 Kalimet e lumenjve/perrenjve	26
	6.3.8 Kalimet e rrugeve	26
	6.3.9 Punimet e betonit	26
6.4	Burimi i ujit	27
	6.4.1 Kaptazhi i burimit	27
6.5	Puset e Shuarjes dhe Rezervuaret	28
	6.5.1 Puset e Shuarjes	28
	6.5.2 Rezervuaret	28
8.1	Grafiku Kohor	30

Lista e Standarteve dhe Rregullave te Aplikuar

EN 124	Pjesa e sipërme e kanaleve dhe pusëve në zonat me trafik dhe kalimtare
EN 805	Nevojat për Furnizim me Ujë për Sistemet dhe komponentet jashtë godinave
EN 12201	Tubat dhe rakorderite PE me dendësi të lartë për furnizim me ujë të pijshëm ,
E DIN 8074	Tubat prej polietileni (PE) PE 40 , PE 50, PE 63, PE 75, PE 90, PE 110, PE100-RC; dimensionet
E DIN 8075	Tubat prej polietileni (PE) PE 63, PE 75, PE 110, PE 125 PE100-RC; kërkesat kryesore të cilësisë, testimi
EN 1171:2002	Saracineskat, Industriale, Gize, Rakorderite e Fllanxhave, Gotat (e filetuara), bashkimet me gotë, Madhësitë
EN 558	Saracineskat Industriale – Dimensionet faqe-faqe dhe qender-faqe të saracineskave metalike për përdorim në tuba me fllanxha.
EN 1092	Fllanxhat dhe bashkimet e tyre
DIN EN ISO 6708	Diametri Nominal
DIN 410 -10-12	Praktika e vizatimit inxhinierik, dimensionimi, konceptet dhe principet e përgjithshme
DIN EN 12201	Tubat prej polietileni (PE) për ujë të pijshëm
DIN EN 10255	Tuba të galvanizuar
DIN 1211/1211	Kembe -shkalle hekuri
DIN 16963	Bashkimet e tubave dhe elementet për linjat e polietilenit me dendësi të lartë (HDPE)
DIN 19630	Udhëzuesit për ndërtimin e linjave të ujës jellës, Kodi DVGW Kodi i Praktikës
DIN 4124	Ndërtimi i gropave dhe kanaleve, pjerresive, gjerësia e hapsirës së punës, shtrimet
DVGW W 400-1	Rregullat teknike për sistemet e shpërndarjes
DVGW W 400-2	Rregullat teknike për sistemet e shpërndarjes: Ndërtimi dhe Testimi
ISO EN 4064	Matesat e Ujit, Kat B për ujë të pijshëm

1 Prezantim

Ky raport pershkruan projektin per furnizimin me uje te fshatit Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik ne Qarkut Korce ne rrethin e Pogradecit , njesi administrative Velcan dhe Proptisht.

Sipas Detyres se Projektimit hartuar nga Bashkia Pogradec eshte hartuar projekti I zbatimit te objektit te **NDERTIMI I UJESJELLESIS RAJONALE I MOKRES (FAZA I)**, i cili ka per qellim te furnizojte me uje te pishem 24 h zonat per te cilat do te sherbeje, ndaj rrjeti ujesjelles qe sot eshte i amortizuar nuk do te jete pjese e linjvae te reja te ujesjellesit, objektet i ketij projekti.

Ne kete Projekt, sipas Detyres se Projektimit, jane parashikuar ndertimi i kaptazhit te ri linjave te reja te ujesjellesit te jashtem dhe shperndares dhe puseve shuares te rinj si dhe rezervuar te reja te pajisura me ndertesa te klorinimit.

Projektimi i stukturave betonarme, si kaptazhe, depo uje, dhoma klorinimi jane pozicionuar sipas studime gjeologjinxhinierike.

2 Objektivat e Projektit

Projekti I zbatimit ka për qëllim sigurimin e furnizimit me ujë të besueshëm dhe higjenikisht të sigurt , prezantimin e tarifave të pranueshme shoqërore që mbulojnë të paktën kostot e operim dhe mirembajte.

Qëllimi i përgjithshëm është të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës rurale në njesine administrative Miras, Devoll.

Objektivat e ketij projekti brenda, jane permbledhur me poshte:

- Kapja e ujit te burimit ne jug-lindje te njesise administrative Velcan dhe sigurimi i nje furnizimi per te plotesuar dhe sigurimin me uje te pijshem per fshatrat Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik.
- Dergimi i ujit te marre, nepermjet nje linje kryesore, ne cdo rezervuar uji, ne nje lartesi te mjaftueshme per sigurimin me presion te cdo fshati.
- Furnizimi i klienteve me uje sipas Legjislacionit Shqiptar dhe kriterëve minimale te meposhtme: furnizim 24 ore me presion te mjaftueshem (min 15 m ne dalje ne cesmen e konsumatorit) me uje me cilesi sipas Standarteve Shqiptare dhe udhezimeve te EU.,
- Sigurimi i nje skeme te projektuar per operim me gravitet
- Eleminimi i puseve dhe elektropompave
- Projektimi i rrjetit shperndares per te siguruar uje ne lidhjet e konsumatoreve me presion minimal prej 1.5 bar m dhe max 6.0 bar

- Projektimi i nje sistemi me jetegjatesi ekonomike prej 25 vjetesh per tubat dhe ndertimet.
- Projektimi i sistemit ne menyre qe punimet e riparimit, mirembajtjes dhe operimit te kene nje kosto minimale.
- Projektimi i sistemit te furnizimit per nje perspektive 25 vjecare
- Furnizimin me uje 24 h te zonave per te cilat do ti sherbeje ky rrjet ujesjellesi
- Rritja e popullsise ne vite do te merret merret nga 1.5% ku perfshihet rritja natyrore dhe levizja demografike e popullates.
- Te kerkesen per plotesimin me uje te pishem te zones, e cila ka per qellim zhvillimn e turizmit malor dhe rekleacioni
- Projektimi i sistemit te furnizimit per nje perspektive 25 vjecare


3 Kushtet e vendit

3.1 Vendndodhja

Fshatrat: BUZAHISHTE, VELCAN, LAKTESH, SOMOTINJE, PROPOTISHT, SLLATINJE, BARIBARDHE, VËRRI, ZALL-TORRE, KRIÇKOVË, SELCË E POSHTME, GOLIK

Qarku (**Korce**) Rrethi:(**Pogradec**) Nj.A:(**Velçan dhe Proptisht**)

Vendndodhja: Fshatrat Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik. jane pjese e njesise administrative Velçan dhe Proptisht e cila ndodhet 17 km ne perendim te qytetit Pogradec, Korçë



3.2 Hyrja ne vend

Distanca mes Tiranës dhe pogradecit është rreth 124 km. Aksesimi për në njësinë administrative Velçan dhe Proptisht është nëpërmjet një rruge dytësore nga rruga nacionale deri në 10 km.

Fshatrat BUZAHISHTE, VELCAN, LAKTESH, SOMOTINJE, PROPOTISHT, SLLATINJE, BARIBARDHE, VËRRI, ZALL-TORRE, KRIÇKOVË, SELCË E POSHTME, GOLIK shtrihen në njësinë administrative Velçan dhe Proptisht. Rruget janë pjesërisht me zhavorr dhe pjesërisht me dhe.

Nga fshati Bishnice deri në burim ka vetëm një shteg kembesorësh. Mjetet e rënda mund të shkojnë në zonën e projektit gjatë gjithë vitit.

3.3 Klima

Klima e zonës së studimit është ajo e jug-lindjes së zonës malore të Mesdheut. Ekziston një klimë mesdhetare-kontinentale me dimra të ftohtë dhe reshje dëbore. Në ditët e sotme, veçanërisht në 15 vitet e fundit, sasia e reshjeve është zvogëluar në masë të madhe, thuhet se shoqërohet me ngrohjen globale. Sasia e reshjeve vjetore varion nga 500 mm në 1000 mm, mesatarja është 750 mm në vit. Shumica e reshjeve ndodhin midis nëntorit dhe dhjetorit, ndërsa më pak në prill deri në maj. Ka masa ajrore kontinentale në këtë zonë, kështu që amplituda vjetore është e madhe. Temperatura mesatare minimale është -10°C në janar-shkurt dhe temperatura maksimale është 30°C gjatë korrikut-gushtit. Në periudhën e dimrit drejtimi mbizotëruar i erës është Lindja dhe Jug-Lindja, ndërsa në verën Jug-Perëndim. Shpejtësia maksimale e erës ndonjëherë arrijn 16m/s , ndërsa minimumi 1.6m/s .

Thellessia e ngrirjes së tokës në zonën e projektit është 0.60m .

3.4 Topografia

Terreni në zonën së projektit është shumë kodrinor me një lartësi mbi nivelin e detit prej 1300 mnd në pikën më të lartë, ndërsa në anën lindore terreni është kodrinor- malor i cili vjen duke u zvogëluar në drejtim të lindjes.

Burimet ujore të shfrytëzuara aktualisht, janë pikesore, por nuk përmbushin kërkesat. Gjate peridhes se veres përmbushin kesasa ne vogla dhe gjate dimrit kane nje regjim me te qendrueshem. Pozicioni gjeografik i zonës së projektit, i shprehur në koordinatat gjeografike, shtrihet midis:

Njesia Administrative Velçan :

Koordinata : $X = 40^{\circ} 57' 05''$

$Y = 20^{\circ} 27' 43''$

$Z = 980\text{m}$

Për referencë të koordinatave është paraqitur mesi i fshatit Velçan.

Njesia Administrative Proptisht :

Koordinatat : X = 40° 59' 50''

Y = 20° 30' 42''

Z = 937 m

Për referencë të koordinatave është paraqitur mesi i fshatit Proptisht.

Burimi dhe Linja Kryesore transportuesse

Burimi Fieri i Keq ndodhet ne pjesen jug lindje te qafes se Klemitit dhe ne perendim te malit Kersakut te ne kuoten 1370 mnd prane fshatit Bisnice 1.7 km ne perendim te saj.

Linja kryesore nga burimi deri ne rezervuar shkon ne drejtim te perendimit duke furnizuar depot e fshatrava, te cilat jane pozicionuar ne koder, te trasuar dhe te pozicionuare ne kuoten me te larte te zones rezideciale.

Fshatrat

Relievi eshte i valezuar me pjerresi ne pergjithesi drejt lindjes. Nievlei shkon nga 1470 m ne 560 m mnd.




Foto- Paraqitja ne harte topografike e burimit

3.5 Kushtet Gjeoteknike dhe Hidrogjeologjike

Gjeologjia në vendndodhjen e projektit është bërë nga shkëmbinj sedimentarë klastikë. Shtresat gjeologjike të formimit përbëhen nga orte ry te, gur ranor, argjilë dhe gur gëlqeror. Këto formacione klasifikohen si mbajtës uji të lartë dhe të mesëm.

Punimet përbëheshin nga rishikimi gjeologjik hidrogelologjik, kryesisht në formën e një trekëndëshi, ku fshatrat e përfshirë janë Sinice, Cete, Miras, Vidohove. Gjatë këtij procesi, nga këto komplekse dolën shkurre natyrore gjeologjike, komplekse uji dhe burime uji, si dhe llojet litologjike dhe hidrogelologjike të ruajtjes dhe formimit që ndërtuan këtë orte ry.

Në këtë ort, veçanërisht vargmalorja malore, ekziston një grup burimesh ujore që aktualisht plotësojnë kërkesën për ujë të pijshëm të këtyre fshatrave. Këto burime natyrore të ujit lidhen me sasinë e reshjeve atmosferike që bien në këtë rajon



Foto- Paraqitja e burimeje siperfaqesore me rrjedhje

3.5.1 Burimi dhe Linja Kryesore Derguese

Struktura gjeologjike e zones konsiston ne conglomerate guresh prej shkëmbinjsh te ndryshem me cimentim prej materiali ranor-karbonat.

Dherat klasifikohen si jo korrozive per hekurin dhe betonin e kategorise C15 ose me te larte.

Deri ne thellesine prej tre metrash nuk jane arritur ujrato nentokesore gjate investigimit

3.5.2 Karakteristikat e Tokes ne zonen e rezervuarit .

Zona ka kushte të mira gjeologjike-inxhinierike dhe ka këtë seksion litologjik me veti të përshtatshme fiziko-mekanike të shtresave.

Toka ka nje vlere ph nga 7.5 ne 8, dhe nuk eshte agresive ndaj betonit te armuar dhe hekurit
Toka ne vendin e rezervuarit, perbehet nga zhavorr dhe conglomerate shkambi deri ne nje thellesi prej te pakten 2 m. Parametrat e tokes jane:

$$\phi = 32^\circ$$

$$\gamma = 25 \text{ Kn/m}^3$$

$$\sigma = 420 \text{ Kn/m}^2$$

3.5.3 Fshati

Nenshtresat e tokes se fshatrave perbehen nga kompleks depozitimesh te Kuaternarit ne nje basen 3 km² te mbushur me depozitime aluviale prej argjile gri, shtresa te holla rere te kombinuar me sedimente.

Rruget e fshatrave perbehen ose prej nje shtrati zhavorri/cakell te ngjeshur ose shtegje natyrore qe perbehen nga argjile e ngjeshur.

3.5.4 Hidrogjeologjia

Burimi

Burimi Fieri I Keq shtrihet jug lindje te qafes se Klemetit dhe ne perendim te malit Kersakut. Toka nëntokësore është e përbërë nga shtresa ranor dhe konglomerati. Sipas studimit të bashkangjitur hidro-gjeologji, rendimenti minimal i burimit është 80 l/s, që ndodh në periudhën midis majit dhe nëntorit. Rendimenti maksimal i pranverës është më shumë se 70% mbi rendimentin minimal dhe ndodh në dimër dhe pranverë. Sipas vlerësimit të hidrologut të Konsulentëve, rendimenti maksimal shkon nga 200-250 l / s.

Burimi i ujit që del nga kontakti logjik litho orte depozitave të molusqeve të bordigjenit përfaqëson shtresat dhe horizontet e ujit, litho logjikisht i përbërë nga pako me rërë të orte dhe gjithnjë duke pasur pllaka argjile alevolite si një shtresë ekzaminimi.




Foto- Pamje te burime ne periudhen e prill-maj

3.6 Sizmiciteti

Sipas hartës sizmike të Shqipërisë, Depresioni I Korçës paraqet një përparim të thellë të mbushur me depozita oligo-miogjene nga epoka e Oligocenës së Mesme. Në të gjithë zonën e studiuar, fenomeni tektonik është i pranishëm. Prania e linjave tektonike ka ndikuar në depozitat e melasës së moshës Neocen-Miocene.

Stili tektonik është i linjave tkurrëse tektonike, përgjithësisht me një prirje të pjerrët, të shkallëve të gdhendura në kuajt. Drejtimi i rënies së vijës tektonike është pothuajse drejtimi SW-NE, sipas vijës së poshtme të Devollit. Kjo linjë tektonike e tipit rrëshqitës të lartë dhe ka ngritur depozita ujore dhe barbare në kushte sipërfaqësore. Drejtimi tjetër i linjave tektonike është pothuajse përtej këtyre vijave tektonike më lart. Ata kanë drejtim SW-NE VP-JL dhe duhet të jenë më të moshuar. Aktiviteti i tyre ka bërë të mundur bllokimin e depozitave të Miocen, të paraprirë nga krijimi i korridorit të Devollit.

EN 1998 Eurocode 8: Dizenjimi dhe ndërtimi i ndërtesave dhe punimeve të inxhinierisë civile në rajone sizmike janë marre parasysh për llogaritjet strukturore

4 Kushtet Socio-Ekonomike dhe Mjedisore

4.1 Popullsia

Sipas të dhenave nga njesite vendore ne vitin 2020 fshatrat si Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik kanë një popullsi totale prej 4 700 banorësh. Rritja e popullsisë është vendosur të llogaritet 1.5 %.

Llogaritja e rritjes se popullsise eshte basuar ne formulen e meposhtme :

$$NP = NS(1+P\%)^n$$

Popullsia Sot (2020) NS

Popullsia Sot (2045)- pas 25 vjetesh NP

Rritja e popullsise (P%)

Vitet e perspektive (n)

Nr	Qendra e banimit (rurale)	Nr I popullsise	Vitet					
			Sot	2020	2025	2030	2035	2040
1	VELCAN	1100	1,100	1,185	1,277	1,375	1,480	1,600
2	BUZAHISHTE	500	500	539	580	625	673	780
3	Golik	336	336	362	390	420	453	450
4	LAKTESH	580	580	625	673	725	781	850
5	SOMOTINE	302	302	325	350	378	407	450
6	Kricovë	378	378	407	439	473	509	560
7	PROPTISHT	483	483	520	561	604	651	710
8	SLLATINJE	316	316	340	367	395	426	460
9	VERI	440	440	474	511	550	593	650
10	ZALLTOR	228	228	246	265	285	307	340
11	Selce e Poshte	77	77	83	89	96	104	120
12	Bari I Bardhe	30	30	32	35	38	40	45
	Totale		4,770	5,138	5,537	5,964	6,424	7,015

Tab- shprehja e rritjes se popullsise sipas te dhenave paraprake

Referuar te dhenave te derguara nga qeverisja vendore, pjese perbere e ketij projekti jane dy njesite administrative kryesore : Velcan dhe Protisht, ndaj per kete arsye qendrave administrative do ti perlogariten edhe normimi I institucionve, si me poshte shenuar :

- Fshatrat Buzahishte, Golik I Siperme, Golik I Poshtem, Lektesh, Somotinje, Krickove, Sllatinje Veri, Zalltor, Selce e Poshtme dhe Bari Bardhe, do te perlogariten me normativen e me poshtme :

Norma per nevoja familjre dhe publike			
Nr	Faktoret e llog	Normimi	Njesia
1	Norma per banore	120	l/banore /dite
2	Humbjet e rrjetit te furnizimit me uje 20%	24	l/banore /dite
3	Totale	144	l/banore /dite
	Prurja per Sek (Q l/s)	0.0017	l/b/ sek

Normat per nevojat teknologjike per ndermjarjet e prodhimit			
Nr	Faktoret e llog	Normimi	Njesia
1	(Prodhime Qumeshti) 1 ton	15	m3
	Prurja	15.00	ton/m3/dite
Normat e perdorimit te ujit per sektore te ndryshem			
Nr	Faktoret e llog	Normimi	Njesia
1	Institucion dhe qendra sociale	3	m3/dite
	Prurja	3.00	m3/dite

Pra perlogritja e rrjetit te ujesjlesit ne baze te nr te popullsise do te jete me 144 l/ banore ne dite. Nga ky konkluzin percaktojme prurjet per dimensionimin e rrjetit te ujesjelelsit per keto njesi.

Llogaritjet per popullsine jane shprehur ne forme tabelare si me poshte :

Nr	Qendra e banimit (rurale)	Nr I popullsise	Vitet		Norma per banore	Q Ditore Max (m3/dite)	Q orare mes(m3/ore)	Koeff orar I jonjetr ajtshmerise k01	Q orare Max (m3/ore)	q sek max (l/sek)
			2020	2045						
		Sot								
1	VELCAN	1100	1100	1600	144	230.4	9.6	1.65	15.84	4.40
2	BUZAHISHTE	500	500	780	144	112.32	4.68	1.65	7.72	2.15
3	GOLIK I POSHTEM	336	336	450	144	64.80	2.7	1.65	4.46	1.24
4	GOLIK I SIPERM	315	315	456	144	65.66	2.736	1.65	4.51	1.25
5	LAKTESH	580	580	850	144	122.4	5.1	1.65	8.42	2.34
6	SOMOTINE	302	302	450	144	64.8	2.7	1.65	4.46	1.24
7	KRICKOVE	378	378	560	144	80.64	3.36	1.65	5.54	1.54
8	PROPTISHT	483	483	710	144	102.24	4.26	1.65	7.03	1.95
9	SLLATINJE	316	316	460	144	66.24	2.76	1.65	4.55	1.27
10	VERI	440	440	650	144	93.6	3.9	1.65	6.44	1.79
11	ZALLTOR	228	228	340	144	48.96	2.04	1.65	3.37	0.94
12	SELCE E POSHTME	77	77	120	144	17.28	0.72	1.65	1.19	0.33
13	BARIBARDHE	30		45	144	6.48	0.27	1.65	0.45	0.12
	Totale		4740	6970	144	1075.82	35.23		58.12	20.55

Logaritjet per qendrat social-kulturore dhe biznesi jane shprehur ne forme tabelare si me poshte :

Nr	Qendra e banimit (rurale)	Nr i bizneseve ne zone	Norma per biznes (m3/dite)	Q Ditore Max (m3/dite) per biznes	Nr i institucioneve ne zone	Norma per institucione (m3/dite)	Q Ditore Max (m3/dite) per institucione	Q Ditore Max (m3/dite) per te dy biz + inst	Q orare mes(m3/ore) ** 8 ore	Q orare Max (m3/ore)	q sek max (l/sek)
1	VELCAN	9	15	135	2	3	6	138	17.250	25.875	0.005
2	BUZAHISHTE	5	15	75	0	0	0	75	9.375	14.063	0.003
3	GOLIK I POSHTEM	3	15	45	0	0	0	45	5.625	8.438	0.002
4	GOLIK I SIPERM	3	15	45	0	0	0	45	5.625	8.438	0.002
5	LAKTESH	1	15	15	0	0	0	15	1.875	2.813	0.001
6	SOMOTINE	2	15	30	0	0	0	30	3.750	5.625	0.001
7	KRICKOVE	1	15	15	0	0	0	15	1.875	2.813	0.001
8	PROPTISHT	13	15	195	2	3	6	198	24.750	37.125	0.007
9	SLLATINJE	4	15	60	0	0	0	60	7.500	11.250	0.002
10	VERI	5	15	75	0	0	0	75	9.375	14.063	0.003
11	ZALLTOR	1	15	15	0	0	0	15	1.875	2.813	0.001
12	SELCE E POSHTME	0	15	0	0	0	0	0	0.000	0.000	0.000
13	BARIBARDHE	0	15	0	0	0	0	0	0.000	0.000	0.000
Totale		47	18	705	4	3	12	708	88.500	132.750	0.025

Kerkesa totale per uje (popullsia, qendra social kulturore dhe biznesi) jane shprehur ne forme tabelare si me poshtem, te cilat do te sherbejne per te dimensionuar rrjetin e dergimit :

Nr	Qendra e banimit (rurale)	q sek max popullsia (l/sek)	q sek max (l/sek) biz+ inst	q sek max (l/sek)
1	VELCAN	4.40	0.0048	4.40
2	BUZAHISHTE	2.15	0.0026	2.15
3	GOLIK I POSHTEM	1.24	0.0016	1.24
4	GOLIK I SIPERM	1.24	0.0016	1.24
5	LAKTESH	2.34	0.0005	2.34
6	SOMOTINE	1.24	0.0010	1.24
7	KRICKOVE	1.54	0.0005	1.54
8	PROPTISHT	1.95	0.0069	1.96
9	SLLATINJE	1.27	0.0021	1.27
10	VERI	1.79	0.0026	1.79
11	ZALLTOR	0.94	0.0005	0.94
12	SELCE E POSHTME	0.33	0.0000	0.33
13	BARIBARDHE	0.12	0.0000	0.12
Totale		20.53	0.0247	20.55

4.2 Situata Socio-Ekonomike

Sipas te dhenave nga njesite vendore, përbërja familjare e një fshati është 3.8 anëtarë / për familje mesatarisht, me rritjen e popullsisë vlerësohet të vazhdojë të rrite, por në këtë model të detajuar merret si konstante për llogaritjet.

Të ardhurat mesatare vjetore të familjeve që nuk marrin ndihmë sociale nga Qeveria shqiptare raportohet të jenë më pak se 25,000 lekë.

Burimet kryesore të të ardhurave ekonomike për popullsinë janë emigracioni, bujqësia dhe bagëtia.

Ekziston gjithashtu një prirje pozitive e njerëzve që merren me kopshtari dhe vreshtari. Aktiviteti i blegtorisë bazohet në bagëti dhe dele, por ky sektor nuk është zhvilluar ende plotësisht.

4.3 Gjendja Mjedisore

Përfitimet mjedisore të kësaj zone vazhdojnë të jenë të larta pasi nuk ka aq ndotje këtu sa në zonat e tjera ku është bërë një problem mjedisor.

Klima është gjithashtu e përshtatshme për pothuajse të gjitha aktivitetet bujqësore. Sasi të mëdha të reshjeve, burimeve natyrore, afërsisë së lumit Devolli dhe tokës pjellore janë të gjithë faktorët që nxisin zhvillimin e bujqësisë dhe kopshtarisë në zonë. Rajoni është i pasur me kullota të përshtatshme për të cilat bazohet zhvillimi i bagëtisë.

Pasi të përfundojnë punimet civile, rrugët që përdoren do të lihen në të njëjtën gjendje si kur filluan punimet.

Projekti i zbatimit parashikon ndërtimin e nje burimi të ujit dhe ndërtimin e 12 rezervuarëve të rinj ne Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik.

Burimi ndodhen ne koder te mbuluar me shkurre dhe peme te vogla.

Linja kryesore derguese do te shtrohet nen toke, gje qe kerkon germim ne toke te forte dhe shkemb. Ne keto seksione dheu i siperm do te ruhet per tu perdorur si shtrese mbuluese, sepse ne te ruhen farat e bimeve.

Rezervuari do te vendoset ne zona me bar dhe shkurre te rralla. Zona qe nevojitet duhet te jete me pak se 150 m2.

5 Punimet topografike

I vetmi informacion topografik ne dispozicion per zonen e projektit eshte nje harte 1:25,000 e vitit 1976. Meqenese ky informacion nuk ishte i mjaftueshem per projektin e zbatimit, Konsulenti ka siguruar fotografi satelitore (shkalle 1:1000) dhe nje Model Dixhital te Terrenit (DTM) te krijuar nga vezhgimi me radar.

Modeli Dixhital eshte zmadhuar dhe ri-kontrolluar meurvejimin topografik tokesor pergjate akseve te Linjes Kryesore Derguese dhe linjave shpernadrese. Modeli Dixhital Tokesor i perftuar eshte perdorur per projektin e detajuar.

Duke marre parasysh faktin qe vendosja e piketave te linjave ne fazen e projektimit mbart rrezikun e demtimit dhe heqjes se tyre dhe me pas do te kerkonte nje perseritje te punes qe

nga fillimi, u përgatit një listë e pikave relevante përgjatë linjave me koordinatat e tyre ekzakto në UTM dhe sistemi i datave dhe koordinatave WGS84 që do të përdoren për vendosjen e skatave të pikave me fillimin e punimeve.

Pjesa më e madhe e tubave janë shtrirë në pronat publike të njësive administrative Velcan dhe Propotisht .

Para fillimit të punimeve të bëhet verifikimi i terrenit dhe i kuotave të dhëna në projektin e sipërpërmendur, si dhe përputhshmëria e kuotave në terren, me kuotat e dhëna në projektin e sipërpërmendur, nga një inxhinier gjeodet i licencuar, në prani të supervizorit.

Në fund të verifikimit të hartohet procesi verbal përkatës.

Për çdo ndryshim, në kuotë, trasim etj. të projektit, të kontaktohet paraprakisht me projektuesin dhe pasi të jepet zgjidhja nga ky i fundit të mbahet një proces verbal, në prani të supervizorit, projektuesit, zbatuesit, dhe të një përfaqësuesi të porositësit.

Në rast, se vërehen ndryshime të kuotave dhe mospërputhje me projektin, të kontaktohet me supervizorin dhe projektuesin dhe të merren masat përkatëse, për zbatimin me korrektësi dhe në përputhje me kushtet teknike përkatëse (K.T.Z. 26 -81 "Kushte Teknike të Zbatimit dhe Marrjes në dorëzim të Punimeve për Ndërtimin e Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësave dhe Kanalizimeve") apo standardet në fuqi.

Punimet duhet të zbatohen rreptësisht me inxhinier gjeodet ose topograf të licencuar për aftësitë e tij në punime zbatimi, sipas planimetrisë dhe profileve gjatësorë, në prezencë të investitorit dhe supervizorit.

6 Skema e Furnizimit me Ujë

6.1 Gjendja Aktuale

6.1.1 Skema Aktuale e Operimit

Aktualisht sot fshatrat Buzahishtë, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërrin, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik furnizohen nga burime pikësore dhe me depo njësi deri në 25 m³ . Rrjeti aktual që i shërben kësaj zone është në gjendje të amortizuar dhe nuk plotëson kërkesat që paraqesin kjo zonë.

Burimet pikësore që furnizojnë kjo fshat janë të vegjël dhe nuk plotësojnë kërkesat për ujë të pishëm plotësisht në stinë e verës.

Me poshtë janë paraqitur të dhënat për depot e ujit për zonat të cilat janë objekt i kësaj detyre projektimi

:

Njësia Administrative Propotisht

i.) Propotisht ka 2 depozita guri që prej 1980, prurja totale në burim 4 L/S

ii.) Veri ka 1 depozitë guri,

- iii.) Selcë e poshtme dhe Krickovë kanë nga 1 depo
- iv.) Slatinë ka 1 depo guri me $V=50 \text{ m}^3$
- v.) Golik dhe Bari i Bardhë kanë nga 1 depo guri.
- vi.) Krickova, prurja totale ne burim është 1.1 L/S

Njesia Administrative Velcan

- a.) Buzaishta furnizohet nga burimi natyror me prurje 3.2 L/S , ka dy depozita me karakteristik, $V_1, V_2=50 \text{ m}^3$
- b.) Velcani furnizohet nga burimi Ujët e Zi Bishnicë me prurje 70 L/S , ka tre depozita me $V_1= 200 \text{ M}^3, V_2=100 \text{ M}^3, V_3=50 \text{ M}^3$

Te dyja zona nuk kane stacione pompimi ne sistemin e dergimit te ujit.
Zonat sanitarie perrreth depove dhe burime nuk jane te mbrojtura.

Rrjeti I shperndarjes i fshtarve eshte ndertuar ne vite '85 dhe eshte jo te mire. Konsumatoret nuk jane te pajisur me matesa dhe nuk marrin sherbim e kerkur per tu furnizuar.

Slabinjë furnizimi kryhet nga burimi Ujët e Zi Bishnicë, destinacioni i të cilit është për furnizimin e disa fshatrave si (Bishnicë, Velcan, Losnik, Slabinjë) sipas ndërtimeve të transmetuesit kryesor me $Q=70 \text{ L/S}$.

Fshatrat si Goliku, Bari i Bardhë, Selishta, Krickova dhe Veri furnizohen me pus.

- i.) Slabinja ka 1 depozite guri që prej 1986, prurja totale në burim 70 L/S
- ii.) Somotina ka 1 depozitë guri që prej 1960, prurja totale në burim 0.5 L/S
- iii.) Proptishti ka 2 depozita guri që prej 1980, prurja totale në burim 4 L/S
- iv.) Veri ka 1 depozitë guri,
- v.) Selcë e poshtme dhe Krickovë kanë nga 1 depo
- vi.) Slatinë ka 1 depo guri me $V=50 \text{ m}^3$
- vii.) Golik dhe Bari i Bardhë kanë nga 1 depo guri.
- viii.) Krickova, prurja totale ne burim është 1.1 L/S

Njësia adminsitative Velcan furnizohet nëpërmjet burimeve natyrore me rrjedhje te lirë, Vjetërsia e rrjetit është mbi 30 vjet në të gjithë zonën dhe e parikonstruktuar, ka rreth 11 depo pjesore.

6.1.2 Permbledhje e Projektimit

Konkluzionet e meposhteme jane nxjerre pas pergatitjes se vizites ne terren per ujesjellesin ne njesine administrative Velcan dhe Propotisht dhe nga vendimet e marra gjate diskutimeve autoritetet e ujit ne zonen e projektit:




Foto-trasimi i rrjetit te Furnizimit me uje

1. Nevojitet nje sistem komplet i ri, konsumi do te matet .
2. Perspektiva e projektit eshte 25 vjet nga 2020. Kapaciteti Linjes Kryesore, rezervuarit dhe linjes shperndarese eshte projektuar per nevojat e vitit 2045.
3. Tubi kryesore nga burimi do te jete PE100 dhe gize sferoidale per nyjet , pusetat e shuarjes dhe ajrusat me diameter qe variojne nga 180 mm, 160 mm dhe 110 mm, 90 mm, 75 mm, 50 mm, 40 mm,
4. Kerkesa totale mesatare ditore per perspektiven 2045 per zonen e projektit eshte llogaritur te jete 1785.96 m3/dite.

Nr	Qendra e banimit (rurale)	Q Ditore Max (m3/dite) popullsia	Q Ditore Max (m3/dite) biz + inst	Q Ditore Max (m3/dite) popullsia + biz + inst
1	VELCAN	230.4	138	368.4
2	BUZAHISHTE	112.32	75	187.32
3	GOLIK I POSHTEM	64.8	45	109.8
4	GOLIK SIPERM	64.8	45	109.8
5	LAKTESH	122.4	15	137.4
6	SOMOTINE	64.8	30	94.8
7	KRICKOVE	80.64	15	95.64
8	PROPTISHT	102.24	198	300.24
9	SLLATINJE	66.24	60	126.24
10	VERI	93.6	75	168.6
11	ZALLTOR	48.96	15	63.96
12	SELCE E POSHTME	17.28	0	17.28
13	BARIBARDHE	6.48	0	6.48
	Totale	779.76	711	1785.96

5. Projekti perfshin nje kaptazh te burimit ne afersi te fshatit Bishnice
6. Njesite e Qeverisjes Lokale aprovojne qe uji nga Burimi do te perdoret ekskluzivisht per furnizim me uje te pijshem per fshatrat Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik.
7. 90% e shtepive te fshatit do te lidhen me skemen e re te furnizimit me uje dhe me matesa per te matur konsumin.
8. I gjithë uji nga burimi deri ne rezervuar do te matet nga mates Thomson, dhe nga rezervuari ne rrjet dhe nga rrjeti tek konsumatoret do te kete mates uji.

6.2 Projekti

Distanca mes Tiranës dhe Pogradecit është rreth 120 km. Aksesit për në njësinë administrative Velcan dhe Propotisht është nepermjet një rrugë e cila del nga Qukes në drejtim të tyre, nga rruga nacionale Perrenjas-Pogradec.

Fshatrat Buzahishte, Velcan, Laktesh, Somotinje, Propotisht, Sllatinje, Baribardhe, Vërri, Zall-Torre, Kriçkovë, Selcë E Poshtme, Golik Rruget në fshatra janë pjesërisht me zhavorr, beton dhe pjesërisht me dhe.

Banesat janë të përqendruara me një distancë prej 10 m mes tyre. Rruget brenda në fshat janë të sistemuara me kalldrem, disa pjesë pranë hyrjeve në banesat janë të shtruara me beton.

Burimi ku do të meret uji është i njohur për banorët dhe ndodhet në një zonë të largët të pabanuar rreth 3km në jug perëndim të fshatit Bishnice mbuluar me shkurre, pemë dhe bimësi të ulët. Ndotja nga herbicidet, insekticidet ose ndotje nga kafshët e njëzërit janë të pamundura.

Linja kryesore nga burimi do të shtrihet përgjatë kreshtave dhe rrugës kembësore që është funksionale.

Kjo linjë lidhet në burim +1470 mnd tek rezervuari me dhomen e klorinimit dhe vazhdon përgjatë një shtegu me një tub gize D₁180 mm me gjatësi 3701 m ku do të bashkohet në Rezervuarin në kuotën 1234 m.




Foto- Skema e Qarkullimit te Furnizimit me uje

Eshte menduar qe cdo fshati ti sigurohet nje prurje mesatare per cdo depo te tij, nga te cilat te mund te llogaritem me ane te paternit (udhezuesve orar) qe te mund te mbuloje te gjithë zonen sipas kerkesa qe ata kane per tu funzinuar me uje 24 h gjate dites.

Linjat akryesore qe shkojne nga depo e kryesore , e cila do te beje edhe klorinimn e ujit, sic edhe eshte evidentuar qe uji do te kete nje dhome klyesore klorinimi dhe per cdo depo do te kete vetem sigurimin e prurjes se maximale orare qe do te shfaqe zona.

